

LOJA SURREALE NË ROMANIN *SHKABA* THE SURREAL PLEY IN THE NOVEL *THE EAGLE*

NELI NAÇO

Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë Shqipe, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, SHQIPËRI
Email: nelinaco@hotmail.com

AKTET VI, 4: 452-455, 2013

PERMBLEDHJE

Romani *Shkaba* i Ismail Kadaresë është një nga romanet më interesante në rrjedhën e romaneve që janë krijuar në letërsinë Shqipe. Është nga veprat e para që shkrimtari e boton jashtë normave të Realizmit Socialist. Romani ka një strukturë të veçantë dhe në të zbulojmë figura të veçanta që kanë lidhje me letërsinë folklorike gojore, me mitin, por edhe është i mbushur me figura dhe vizione sureale, ndërsa qëllimi artistik i veprës është kryesisht që tu japë një domethënie simbolike veprimeve që ndodhin në vepër.

Ky është një nga qëllimet e shkrimit që të zbulojë lojën surreale që shkrimtari realizon në këtë vepër, si dhe disa nga marrëdhëniet e veprës me folklorin dhe letërsinë orale. Për ne surealizmi nuk është qëllimi i fundit që autori përpiqet të arrijë me këtë vepër, por më tepër është një lojë, e cila është realizuar me mjeshtëri për të përmbytur qëllimin përfundimtar të autorit.

Fjalët kyçe: surealizëm, imazh, vizion, mit, folklor, lojë.

SUMMARY

Ismail Kadare's novel "The eagle" is one of the most interesting novels in the stream of the novels ever written in Albanian literature. It is one of the first works the writer has published beyond the norms of the socialist realism. The novel has a special structure and in it we discover special characters that are related to the oral folk literature, myth, being filled with surreal figures and visions as well, while the artistic goal of the work is mainly to provide the actions which happen in the novel with a symbolical significance.

One of the goals is to reveal the surrealist game the author realizes as well as some of the relations to the folklore and oral literature. To us surrealism is not the final goal that the author is trying to achieve; it is rather a game masterfully realized in order to achieve the author's final goal.

Key words: surrealism, image, vision, myth, folklore, play.

Hyrje

Romani *Shkaba* i Ismail Kadaresë vjen në një kohë kur gjithë letërsia shqipe sa vjen dhe më shumë përpiqet të çlirohet nga format e imponuara të realizmit socialist. E botuar më 1996 ajo është një dëshmi e re e lirisë së shprehjes artistike, ndonëse jo e vetmja.

Vepra e Ismail Kadaresë në faza të caktuara të krijimtarisë së këtij shkrimtari rreh të çlirohet herë më ngadalë dhe herë më fort prej formave socrealiste. Surrealizmi mund të përbëjë njëkohësisht një mjet të fuqishëm artistik, i cili

nuk do të shprehë domosdoshmërisht përkatësinë e autorit me rrymën letrare, por do të fuqizojë shkrimin me elementë që kanë të bëjnë me oniriken, botën e ëndrrave, folkloriken dhe imagjinaren. Autori që shkel në këtë truall shpeshherë krijon lidhje jo të drejtpërdrejta edhe me surealizmin si rrymë letrare. Në rastin e Kadaresë do të shpreheshim se ai luan me elementin surreal, e përdor atë pa qenë një anëtar i mirëfilltë i rrymës letrare.

Dialogu me surrealen

Ajo që, në këtë roman na ka tërhequr vëmendjen është tendenca që ka shkrimtari për të luajtur me surrealen, tipar që mund të vihet re edhe në vepra të tjera të autorit, fjala vjen te *Pallati i ëndrrave*” (Naço 2012: 57). Në një mënyrë origjinale krejt të ndryshme nga letërsia shqipe, por edhe nga vepra të tjera të shkruara më parë prej autorit dënimi politik shndërrohet në një rënie të vrullshme dhe të pafundme të personazhit Maks në një humbëtirë. Përfundimi nuk është vrasja apo plagosja e personazhit, por qëndrimi i tij në një botë tjetër “provincë”, ku njerëzit si ai etiketohen me të njëjtin emër “të rrëzuarit”. Veprime reale të përziera me veprime të pamundura.

Ajo që po përpiqem të them është se Kadare ka krijuar me këtë vepër një lojë me surrealen dhe jo një vepër surrealistike tipike në mjedis krejtësisht joreal, e ngjashme me veprat e lëvizjes surrealistike të fillimeve të shekullit të 20-të. Ai nuk përpiqet që të krijojë një vepër që të gjenerojë mendimin e pavetëdijshëm në një truall artistik, siç na sugjeron përkufizimi i Breton-it për surrealizmin. Ai nuk synon të krijojë një “automatizëm psikik në gjendjen e tij të pastër, me anën e të cilit dikush sugjeron të shprehë – verbalisht, domethënë me fjalën e shkruar, apo në ndonjë mënyrë tjetër – funksionimin aktual të mendimit” (Breton 1969: 26). Kadareja më tepër përpiqet që ta ndryshojë gjendjen duke kaluar prej rrethanave reale në rrethana simbolike të letërsisë që krijon.

Bota onirike

Rënia e Maksit është një rënie krejtësisht simbolike. Ajo parathuhet dhe pastuhet që është një rënie politike apo më mirë një dënim politik, por në veprën e Kadaresë ka një paraqitje surrealistike, onirike dhe simbolike. Kthimi në realitet është po ashtu i papritur dhe i beftë. Rënia sugjeron thyerje, vrasje plagosje, por personazhi del i padëmtuar nga kjo. “Ajo iu rikthye një grimë për t’iu tretur prapë, por sa herë që ndodhte kjo atij i dukej se vazhdonte të binte. Pas xhudo teposhtjeje ishte një teposhte e re, pjellë e së parës, por e gatshme edhe ajo të

pillte aty për aty një tjetër. Ky shumëfishim i zgavrimit /.../ e lodhi atë më fort se krejt jeta e tij prej njëzetedy vitesh... Do të besonte se ishte zgjuar nga një ëndërr e keqe, kur e pa veten përpara një kafe-bari, në këmbë pa kurrfarë plagësh në trup.” (Kadare 1996: 9 – 10).

Ashtu si beson edhe Breton-i fragmenti i mësipërm është një përzjerje e dy gjendjeve: ëndërrës dhe realitetit, që mund të duken kontradiktore dhe krijojnë një realitet absolut, një surrealistet, i cili synon të jetë njëkohësisht nën këndvështrimin e Kadaresë një realitet simbolik, ku domethëniet politike janë fshehur pas rrethanave të tilla.

Rënia si veprim është shumë e lidhur me botën onirike dhe me imazhin surreal në rrethana të tjera për shkak të humbjes së orientimit dhe për shkak të mospranisë së orientimit fizik. Rënia interpretohet edhe si ngritje, si fluturim, duke krijuar një lojë verbale po aq surreale sa dhe vetë imazhi surreal i rënies së pafundme.

Shpeshherë përzjerja e të kundërtave mohuese përbën një tipar të letërsisë surrealistike dhe, për receptuesin e veprës së artit kjo përzjerje shkakton një lloj disorientimi. Personazhit Maks i ndodh një gjë e tillë: “Trishtueshëm ai dëgjonte fjalët e tjetrit. Shumë gjëra në trurin e tij do të qortoheshin. Do të shikonte aeroporte ose hone zbritëse, ose përkundrazi, mjete ngjitëse atje ku s’kishte kurrëgjë të tillë. Nga të gjitha përmasat e botës njëra do të bëhej zotëruese: lëvizja teposhtë ose terma. Me fjalë të tjera ngjitja ose zbritja.” (Kadare 1996: 21).

Rënia mistike

Rënia mistike, e cila krijon ndjesinë e surreales në veprën *Shkaba* nuk është e njëjtë, ndërsa Maks rrëzohet pranë stendave të teatrit kombëtar në një humbëtirë, e cila duket sikur prodhon humbëtirë të tjera. Gazmend Hila rrëfen rënien e vet “një ditë në ashensorin e ndërtesës së rektoratit, ndërsa zbriste, dritat ishin shuar dhe ashensori s’kishte pushuar së zbrituri gjersa e kishte lëshuar këtu” (Kadare 1996: 21). Ndërkohë rënia e familjes së Anës realizohet përmes një tuneli prej të cilit nuk kishin dalë dot më.

Duke diskutuar për shkrimtarin Skënder Berema nëse ishte i rënë apo jo situata surreale bëhet më interesante Maksi shprehet se ai i ka të dy gjendjet. Pra është i rënë, po edhe jo.

Dialogu me përrallën

Të gjithë shembujt nga narracioni i veprës tregojnë se Kadare nuk është i interesuar të deprettojë në një botë totalisht onirike, surreale ku personazhet e tij të gjallojnë midis saj si në një përrallë dhe ku çdo element është i ndryshëm ose pothuajse i ndryshëm nga bota reale. Personazhet e Kadaresë nëpërmjet situatave momentale surreale kalojnë nga një gjendje në një tjetër dhe pas kalimit bota e tyre është po aq normale sa e para. Nuk kemi pra një kalim në një botë onirike të vazhduar, porse nëpërmjet situatës pjesore surreale kemi një kalim në një pjesë tjetër të botës reale që ekziston paralelisht, siç mund të jetë provinca ose vendi i internimit.

Kadareja ka krijuar kështu një lloj të mrekullishmes. Andre Breton thotë: “Në arealin e lehtësisë, vetëm e mrekullishmja është e aftë për të mbarsë vepra të cilat i përkasin një kategorie inferiore, siç është romani dhe, po të flasim në përgjithësi, gjithçkaje që përmban rrëfim” (Breton 1969: 14). Po aty ai përsëri shprehet “le të mos i thërrmojmë fjalët: e mrekullishmja është gjithmonë e bukur, gjithçka e mrekullishme është e bukur, në fakt vetëm e mrekullishmja është e bukur” (Breton 1969: 14).

E mrekullishmja e përrallës shqiptare ku qerosi, pasi është flakur nga vëllezërit e tij në botën e poshtme, përpigjet të dalë prej andej duke e ushqyer shkabën me mish, është ndërkalur në roman si ringjallje e një vizioni të vjetër, por të pasuruar me ide të reja dhe më së shumti me mesazhin që Kadare nuk e anashkalon asnjëherë, me mesazhin politik. Përralla mbart me sa duket atë që Max Ernst-i e quante “bashkimi i dy realiteteve të pajtueshëm në dukje, mbi një plan, i cili dukshëm nuk u përshtatet atyre” (Clifford : 539). Maks Ernst e ka artikulluar frazën pa dyshim për artet vizuale por e njëjta gjë ndodh me sa duket edhe në artin letrar.

E mrekullishmja e përrallës mbart edhe diçka tjetër në vetvete, të ngjashme me atë që James

Clifford e ka quajtur “surrealizmi etnografik”. Njëlloj si për avangardën Parisiane Afrika siguronte një rezervuar të formave të tjera dhe besimeve të tjera edhe për Kadarenë e mrekullishmja e përrallës apo surrealiteti i përrallës i siguron një material të mjaftë që ai të realizojë lojën e tij letrare. Surrealja primitive e përrallës është si një burim tjetër alternativ estetik kozmologjik dhe shkencor.

Paralelizmi i dy botëve, që funksionojnë pavarësisht njëra tjetrës, lidhja e të cilave është e vështirë të realizohet në të dy rastet, edhe zbritja poshtë është e vështirë, por ngjitja sipër është akoma më e mundimshme janë jehona intertekstuale të surreales së përrallës e cila reflektohet në shkrimin kadarean.

Imazhi i dyzuar

Edhe një çmitizim, i cili buron prej nevojës për ta pasuruar shkrimin letrar me ide dhe mesazhe politike, do t'i shtohet tekstit në fjalë. Shkaba që simbolikisht është simboli i shtetit, edhe atij komunist, nuk është elementi me shpirt human që ndihmon qerosin e përrallës, por është simboli i një shteti që përpigjet të marrë nga individit përveç trupit edhe shpirtin, por që personazhi Maks ngurron ta japë dhe përpigjet të çlirohet vetë i pari.

Imazhet e dyzuara përsëri janë një tipar i ikonologjisë surrealiste. Them i ikonologjisë surrealiste, sepse, si rrallë ndonjëherë, duke e krahasuar me ndonjë lëvizje tjetër, lidhja me imazhin, perspektivën dhe deformimin e tij është shumë e fortë në lëvizjen surrealistë pavarësisht nëse vepra është vepër e arteve figurative, apo e artit letrar. Ana është e shfaqur herë si dy persona dhe herë si një person i vetëm, kurse ndonjëherë e ndarë: trupi në botën lart dhe shpirti në botën poshtë.

Imazhet dhe deri tek peizazhet mbartin vlerën përshkrimore surrealistë piktorike, tablo që të kujtojnë pikurat e piktorëve të hershëm të quajtur shpeshherë si pararendës të lëvizjes surrealistë si Hieronymus Bosch, apo Pieter Bruegel Plaku, dhe deri tek piktorë të tillë surrealistë si Salvador Dali, Max Ernst apo Rene Margrite. Humnera, shkabat që ngjiten lart në

largësi, shkabat që kthehen poshtë me skelete, përshkrimi i organeve njerëzore duke zotëruar atë pamje që sheh personazhi, si të jenë të vendosura para syve të tij, na shpjen drejt vizioneve surreale.

Përfundim

Mbyllja e romanit *Shkaba*, racionaliteti i mbylljes, cerebralja në dëshmitë e njerëzve të tjerë, krijimi i një bote objektive nëpërmjet dëshmime të këtyre personazheve shenjojnë një rikthim në vetëdijen e rrëfimit, dëshmojnë jo një humbje të autorit në onirikën, por daljen jashtë prej saj; shenjojnë përsëri daljen nga miti surrealist dhe përforcimin e efektit të lojës me surrealen. Të gjitha këto tregojnë jo për një vepër që rreh të

krijojë sipas standardeve të kësaj rryme letrare, por për një vepër që luan me këtë imazh dhe na jep një dëshmi më tepër të modernitetit kade-rean.

Bibliografi

BRETON Andre (1969), *Manifestoes of surrealism*, The University of Michigan Press.

CLIFFORD James, *On ethnographic surrealism, Comparative studies in society and history*, Vol. 23, No. 4.

KADARE Ismail (1996), *Shkaba*, Çabej, Tiranë.

NAÇO Neli (2012), *Imazhi i labirintit në veprën Pallati i ëndrrave: Tempulli, Tiranë*, Nr. 17..